



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 68, datë 7.10.2016

**PËR
“DISA NDRYSHIME NË NIVELIN E PAGAVE DHE NUMRIN E PUNONJËSVE TË
INSTITUIONEVE TË VARËSISË ”**

Në mbështetje nenit 8 pika 2, dhe nenit 54 shkronja “ç” dhe “dh”, nenit55, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 5, shkronjat “a” dhe “d” të Ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; pikes 17 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165, datë 02.03.2016 për “Grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.11, datë 05.04.2012, për “Ristrukturimin e Qendrës Sociale “Të qëndrojmë së bashku”, “Qendrës komunitare multidisiplinare për fëmijët dhe familjet në nevojë” dhe “Qendrës komunitare për të moshuarit”, miratimin e strukturave të tyre organizative si dhe rishpërndarjet në buxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2012”; Vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr. 60, datë 24.12.2012 për “Krijimin e qendrës komunitare Shkozë dhe miratimin e strukturës së saj organizative si dhe një shtesë në numrin e përgjithshëm të strukturës organizative të qendrës sociale “Të qëndrojmë së bashku”, qendrës sociale multidisiplinare dhe qendrës sociale “Shtëpia e Përbashkët”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.4, datë 01.03.2012 për “Krijimin e qendrës sociale “Shtëpia e Përbashkët” dhe miratimi i strukturës organizative”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 51, datë 11.11.2015, “Për një ndryshim në nivelin e pagave të institucioneve të varësisë dhe për kalimin e punonjësve të Policisë së Njësive Administrative (ish komunave), Policisë Bashkiake të Tiranës ” dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, për “Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” (i ndryshuar), me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, sipas lidhjes nr.11 bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e qendrave sociale: “Të qëndrojmë së bashku”; “Qendrës sociale multidisiplinare”, “Qendrës komunitare Shkozë” dhe “Qendrës sociale “Shtëpia e përbashkët”, sipas lidhjes nr.9 bashkëngjitur këtij vendimi.

3. Të miratojë shtesën e :
 - 2 (dy) punonjësve në qendrën sociale: “Të qëndrojmë së bashku”;
 - 2 (dy) punonjësve në qendrën sociale: “Shtëpia e përbashkët”
 - 3 (tre) punonjësve në “Qendrën sociale multidisiplinare”
4. Të miratojë një shtesë prej 45 punonjësish në Qendrën Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.
5. Të miratojë një shtesë prej 26 punonjësish në Drejtorinë e Përgjithshme nr.3 të Punëtorëve të Qytetit.
6. Efektet financiare të këtij vendimi, fillojnë më 1 Tetor të vitit 2016 dhe përballohen nga buxheti i këtyre Institucioneve për vitin 2016.
7. Në mbështetje të pikës 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi rekomandohet hartimi dhe miratimi i strukturës organizative për qendrat sociale: “Të qëndrojmë së bashku”; “Qendrës sociale multidisiplinare”, “Qendës komunitare Shkozë” dhe “Qendrës sociale “Shtëpia e përbashkët”, Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve dhe Drejtorisë së Përgjithshme Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit.
8. Të shfuqizojë lidhjen e pagave nr.9 në pikën 3 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 60, datë 24.12.2012.
9. Të shfuqizojë lidhjen e pagave nr.11 në pikën 7 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 51, datë 11.11.2015.
10. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Qendrat Sociale: “Të qëndrojmë së bashku, “Qendra sociale multidisiplinare” dhe “Qendra sociale “Shtëpia e përbashkët”, “Qendra komunitare Shkozë”, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë së Tiranës.
11. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

Lidhja Nr.11**Niveli i pagave për punonjësit e “Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”**

Nr	Pozicioni	Paga individuale			Paga mujore	
		Kategoria	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion	Shtesa për kushte pune
			1	2	3	
1	Kryeinspektor	II-a	1	2%	102 000	
2	Drejtor	II-b	1	2%	85 000	
3	Përgjegjës sektori	III-a/1	1	2%	60 000	
4	Përgjegjës sektori te zonave	III-a/1	1	2%	60 000	5 000
5	Inspektor	III-b	1/2	2%	55 000	5 000
6	Specialist I	III-b	1/2	2%	55 000	
7	Specialist II	IV-a	1/2/3	2%	44 000	
8	Specialist me arsim të mesëm	IV-c	4	2%	35 000	5 000
9	Punonjës mbështetës, shofer				36 000	
10	Pastrues				30 000	

Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr. 11**, të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË E TË MESËM

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë
4	Diplomë e arsimit të mesëm	8 000 lekë

Lidhja Nr.9

Niveli i pagave për punonjësit e Qendrave sociale

Nr	Pozicioni	Kategoria	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
<i>I</i>			1	2	3
1	Drejtor Drejtorie	II-b	1	2%	80 000
2	Pergjegjes	III-b	1	2%	45 000
3	Financier, Jurist	IV-a	1/2	2%	37 000
4	Punonjës social, Psikolog, Terapist, Fizioterapist, Mjek, Edukator, Operator Social	IV-b	1/2/3	2%	34 000
5	Ndihmës kuzhine, Mirëmbajtes, Shofer				34 000
6	Pastrues, roje				30 000

1.Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr. 9** të jepet në masën **2%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet **mbi pagën e grupit**.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË E TË MESËM

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë